

Glauk Haxhijaj është i ri i përkushtuar ndaj fuqizimit të të rinjve në Kosovë dhe rajon, duke krijuar platforma ku ata mund të shprehen, të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë ide që ndikojnë në të ardhmen e tyre. Angazhimi i tij në shoqërinë civile është ndërtuar përmes projekteve si Utopian Kosova, që inkurajon të rinjtë të mendojnë kritikisht për rolin e tyre në shoqëri, dhe Kosovo4Green, me fokus në ekonomi qarkore dhe qëndrueshmëri. Gjithashtu, përmes angazhimit të tij në Cult Club, ai ka kontribuar në avancimin e dimensionit ndërkombëtar të festivalit Summer Cult, duke forcuar bashkëpunimet me artistë dhe organizata jashtë vendit.

Ai është themelues i organizatës Iniciativa për Zgjidhje Inovative (IZI), e cila brenda një viti ka siguruar mbi 15,000 EUR mbështetje nga institucione shtetërore dhe donatorë ndërkombëtarë.

Me sfond në ekonomi dhe menaxhment, ai është vlerësuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për hulumtimin e tij mbi ekonominë qarkore dhe ndikimin e institucioneve në zhvillim.

Glauku beson se të rinjtë duhet të jenë jo vetëm pjesëmarrës, por edhe vendimmarrës aktivë në shoqëri, dhe synon të forcojë bashkëpunimin rajonal përmes iniciativave që lidhin të rinjtë përtej kufijve.